



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

Drejtoria e Planifikimit Strategjik
Raporti mujor, Janar 2022

PROJEKTET :

- Mbledhja e informacioneve dhe përgatitja e portfoliove për: Projekt A- Rigjenerimi i Kodrës së Trimave, Projekt C – Tuneli tek pjesa e vjetër e qytetit, Projekt D – Tuneli që lidhë lagjen Dardania me Kalabrinë, Projekt E – Pjesa e vjetër e qytetit, Projekt F – Unaza e brendshme;
- Pjesë e punës gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe mbledhja e informacioneve dhe përpunimi i të dhënave së bashku me Robert Ferrier për të kompletuar dosjet për projektet si: Parku në Kampusin e Universitetit, Stacioni i Autobusëve, një pjesë e lagjes Kalabria, Zona e vjetër e qytetit, tregu, kullat në lagjen Ulpiana;
- Ka nisur mbledhja e informacioneve të nevojshme nga Drejtoritë përkatëse për të kompletuar dokumentin që do t'i shërbejë shpalljes së konkursit ndërkombëtarë për projektin e Muzeut të Artit Modern tek Tulltorja si dhe projektit tek Pallati i Rinisë dhe Sportit;
- Projekti për renovimin dhe inventarizimin e Q.M.F IV- është projekt që vazhdon akoma dhe në këtë fazë është bërë përgatitja dhe përzgjedhja e inventarit.

AKTIVITETET:

- Trajtim i kërkesave "Informatë nga Plani";
- Bashkëpunim me drejtoritë tjera rreth planifikimit.

VIZITAT NË TEREN:

- Vizitë në terren në Qendrën e Mjekësisë Familjare IV;
- Vizitë në terren në të gjitha lokacionet ku është punuar në mbledhjen e materialeve për pesë projektet madhore në Prishinë.

TAKIMET :

- Takime të rregullta me këshilltarin Robert Ferrier rreth projekteve;
- Takime të rregullta me Drejtorinë e Pronës dhe Planifikimit rreth projekteve të ndryshme;
- Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë rreth projektit për renovimin dhe inventarizimin e Q.M.F IV;
- Takimet e rregullta me palë, sipas ditëve të caktuara.